



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR SHKUMBIN

VENDIM
Nr.8, datë 21.11.2022

PËR
**RINOVIMIN E LEJES NR.192 PROT., DATË 25.3.2022 MIRATUAR
ME VENDIMIN NR.3, DATË 17.3.2022 "PËR PËRDORIM BURIMI
UJOR KURATIV, MINERAL, TERMOMINERAL DHE
GJEOTERMAL (LLIXHA),
SUBJEKTIT "BOÇI 2020"**

Në mbështetje të nenit 112, të Kodit të Proçedurave Administrative, pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin.

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për rinovimin e lejes nr.192 prot., datë 25.3.2022 miratuar me vendimin nr.3, datë 17.3.2017 të Këshillit të Basenit Ujor Shkumbin për "Përdorim burimi ujor kurativ, mineral, termomineral dhe gjeotermal (llixha)" subjektit "Boçi 2020" me Adresë Njësia Administrative Tregan Elbasan Qarku Elbasan.
2. Vendndodhja e veprës së marrjes (KRGJSH)
- X= 506378.3; Y= 4544022.3; Z= 166 m.m.n.d
Sasia e ujit që jepet në përdorim: Q=0.0003 m³/s
3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

**KRYETARI I KBU SHKUMBIN
MAJLINDA PERRIU**

